



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:019651

Datë: 10.01.2025

Numri i dokumentit: 06696382

KF.nr.616/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar –administrativ të paditësit “Joe Travel”, Sh.P.K. me numër unik identifikues 810359853 dhe me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Administrata Tatimore Kosovës me seli në Prishtinë, për anulimin e vendimit, jashtë seancës, me datë 10.01.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet se është tërhequr padia e paditësit “Joe Travel” Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, e regjistruar nën shenjë KF.nr.616/22 e datës 01.02.2022, për mos pagesën e taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësi, më datë 01.02.2022, ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, për anulimin e vendimit me nr.581/21 të datës 17.12.2021.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, lënda A.nr.215/2022 është transferuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti Administrativ-Divizioni Fiskal, për në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Divizioni Fiskal, për shqyrtim të mëtejme në bazë të kompetencës lëndore, dhe ka marrë numrin KF.nr.616/22.

Gjykata, paditësit i ka dërguar vërejtjen gjyqësore me të cilën e ka obliguar të paguaj taksën gjyqësore në vlerë prej 40 euro, në afatin prej 15 ditëve.

Nga fletë kthesa për dorëzim personal vërtetohet se paditësi vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore e ka pranuar më datë 21.10.2024, mirëpo paditësi as në afatin e caktuar me vërejte dhe as deri në ditën e nxjerrjes së këtij aktvendimi nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Duke pasur parasysh që paditësi në afatin prej 15 ditëve sipas vërejtjes së gjykatës, nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore edhe pse në vërejtjen e gjykatës për pagesën e taksës gjyqësore, është paralajmëruar se në qoftë se në afatin e caktuar nga gjykata nuk e paguan taksën gjyqësore, konform Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të ndryshuar sipas UA nr.2/2017 për Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore e lidhur me nenin 253 të LPK-së, padia do të konsiderohet se është tërhequr.

Pasi që paditësi nuk ka paguar taksën gjyqësore dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore, gjykata duke marrë parasysh arsyet e dhëna me lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të ndryshuar sipas UA nr.2/2017 për Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal

KF.nr.616/22, datë 10.01.2025

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.